

20180110127

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR NËPUNËS ADMINISTRATIVË

Neni 1

Në Ligjin për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16), në nenin 7 paragrafi (1) në pikën 15) fjalët: "dhe testi i personalitetit" shlyhen.

Pika 16) shlyhet.

Pikat 17), 18), 19), 20) dhe 21) bëhen pika 16), 17), 18), 19) dhe 20).

Në paragrafin (2) fjalët: "18, 19 dhe 20" zëvendësohen me fjalët: "18, dhe 19".

Në paragrafin (3) fjalët: "18, 19 dhe 20" zëvendësohen me fjalët: "18, dhe 19".

Neni 2

Në nenin 14 në alinenë 4 pas fjalës "nëpunës" presja zëvendësohet me lidhëzën "dhe", ndërsa fjalët: "dhe testi i personalitetit" shlyhen.

Neni 3

Në nenin 16 paragrafi (1) në alinenë 7 pas fjalës "BULATS,", shtohet fjala "APTIS,".

Neni 4

Në nenin 24 në paragrafin (2) pika g) ndryshohet si vijon:

"g) kompetenca të veçanta të punës për të gjitha nivelet - njohje aktive e njërës nga tri gjuhët e përdorura më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze dhe gjermane), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, provim të dhënë për menaxhim administrativ dhe kompetenca të tjera të veçanta të punës të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës për vendin përkatës të punës."

Paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (3).

Neni 5

Në nenin 25 në paragrafin (2) pika g) ndryshon si vijon:

"g) kompetenca të veçanta të punës për të gjitha nivelet - njohje aktive e njërës nga tri gjuhët e përdorura më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze dhe gjermane), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të veçanta të punës të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës për vendin përkatës të punës."

Paragrafi (3) shlyhet.

Neni 6

Në nenin 26 në paragrafin (2) pika g) ndryshon si vijon:

"g) kompetenca të veçanta të punës për të gjitha nivelet - njohje aktive e njërës nga tri gjuhët e përdorura më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze dhe gjermane), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të veçanta të punës të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës për vendin përkatës të punës."

Paragrafi (3) shlyhet.

Neni 7

Në nenin 36 paragrafi (1) në alinenë 4 fjalët: "gjuhë, niveli sipas CEFR (CEFR) ose pikë sipas TOEFEL PBT, CBT ose IBT" zëvendësohen me fjalën "të cilat".

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Fletëparaqitjes kandidatët detyrimisht ia bashkëngjisin dëshmitë vijuese për të dhënat e futura në të njëjtën, në formë të skanuar:

- dëshmi për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë,
- dëshmi për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- certifikatë/diplomë për shkallën e kryer të arsimit,
- vërtetim për punë me programe për punë në zyrë dhe
- vërtetim për provimin e dhënë profesional ose licencë ose certifikatë nga sfera përkatëse profesionale, nëse të njëjtat janë kusht i veçantë për vendin e punës dhe janë të shënuara në shpallje publike."

Neni 8

Në nenin 38 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"(1) Procedura për selektimin e punësimit përbëhet prej tri fazave edhe atë selektim administrativ, provim për nëpunës administrativ dhe kontroll të autenticitetit të provave dhe intervistë."

Neni 9

Në nenin 39 paragrafët (9) dhe (10) shlyhen.

Paragrafi (11) bëhet paragraf (9).

Pas paragrafit (12), i cili bëhet paragraf (10), fjalët: "paragrafi 11" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi 9".

Në paragrafin (13), i cili bëhet paragraf (11), fjalët: "vendet e punës" zëvendësohen me fjalën "realizues" dhe fjalët: "paragrafi (11)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (9)".

Në paragrafin (14), i cili bëhet paragraf (12), fjalët: "paragrafi (13)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (11)".

Neni 10

Neni 40 ndryshon si vijon:

(1) Kandidati për nëpunës administrativ jep provim për nëpunës administrativ të cilin e organizon dhe e zbaton Agjencia.

(2) Provimi për nëpunës administrativ përbëhet nga dy pjesë edhe atë pjesa profesionale dhe pjesa për kontroll të dijes së njërës nga tri gjuhët e shfrytëzuara më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze, dhe gjermane).

(3) Me pjesën profesionale, nëpërmjet përgjigjes së pyetjeve në formë të testimit me kompjuter, kontrollohen njohuritë e kandidatit në sferat në vijim:

- rendi kushtetues i Republikës së Maqedonisë,
- sistemi i vetëqeverisjes lokale,
- sistemi i të drejtës administrative, procedura administrative dhe kontesti administrativ,
- pozita dhe çështjet tjera të përgjithshme për të punësuarit në sektorin publik, të drejtat për marrëdhënie pune të nëpunësve administrativë dhe
- Kodeksi për nëpunësit administrativë.

(4) Me pjesën për kontrollin e dijes së njërës nga tri gjuhët më të shfrytëzuara në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze, gjermane), nëpërmjet përgjigjes së pyetjeve në formë të testimit kompjuterik, kontrollohet njohuria e kandidatit për gjuhë të huaj.

(5) Bazën e pyetjeve për pjesën profesionale e formon Ministria në bashkëpunim me Agjencinë, me ç'rast së paku një herë në vit e njëjta revidohet.

(6) Baza e pyetjeve nga paragrafi (5) i këtij neni është e qasshme publikisht në ueb faqen e Ministrisë dhe të Agjencisë dhe përmban së paku 500 pyetje, për të cilat janë dhënë rregullat nga të cilat dalin pyetjet.

(7) Bazën e pyetjeve për pjesën për kontrollin e njohjes së njërës nga tri gjuhët më të shfrytëzuara në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze, gjermane) e siguron Ministria nga katedrat e gjuhës angleze, franceze dhe gjermane në fakultetet filologjike të institucioneve publike të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

(8) E qasshme publikisht dhe e publikuar në ueb faqen e Ministrisë dhe të Agjencisë është edhe literatura në bazë të së cilës është përgatitur edhe baza e pyetjeve nga paragrafi (7) i këtij neni.

(9) Gjatë revizionit të pyetjeve nga paragrafi (5) i këtij neni, Ministria në veçanti i ka parasysh ndryshimet e rregullave juridike në të cilat bazohet pyetja, numri i kandidatëve të cilët i janë përgjigjur, suksesi gjatë përgjigjes së të njëjtave, si dhe rrethanat tjera të cilat mund të ndikojnë mbi përmirësimin e kualitetit të bazës me çka vendos që pyetje të caktuara të ndryshohen ose të largohen plotësisht.

(10) Pyetjet për provimin për nëpunës administrativ, varësisht nga pesha, vlerësohen me numër të përcaktuara të pikëve, të cilat janë theksuar për çdo pyetje gjatë kohës së dhënies së provimit dhe ato për çdo kandidat zgjidhen me zgjedhje të rastësishme nga bazat e pyetjeve nga paragrafët (5) dhe (7) të këtij neni.

(11) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni me provimin për nëpunës administrativ në diplomaci, administratë doganore dhe tatimore dhe shërbimet inspektuese, revizionin shtetëror dhe revizionin e IPA-s, si dhe në trupat revizorë kontrollohen njohuritë e kandidatit në sferat tjera të përcaktuara me ligjet e veçanta.

(12) Bazat e pyetjeve për provim për nëpunës administrativ nga paragrafi (11) i këtij neni i formon dhe i revidon institucioni për të cilin zbatohet provimi.

(13) Në afat prej tri ditësh nga dita e zbatimit të provimit, në pajtim me pikët e fituara nga selektimi administrativ i provimit, Komisioni përgatit dhe e publikon në ueb faqen e Agjencisë, rang-listën me kode identifikuese të kandidatëve.

(14) Data dhe koha e mbajtjes së fazës së ardhshme të selektimit publikohen së bashku me rang-listën e paragrafit (13) të këtij neni dhe e njëjta nuk mund të jetë më vonë se dhjetë ditë nga dita e publikimit.

(15) Më së shumti pesë herë më shumë kandidatë nga numri i realizuesve për të cilët zbatohet procedura, dhe të cilët kanë qenë më mirë të radhitur në listën nga paragrafi (3) i këtij neni, kalojnë në fazën e ardhshme të selektimit.

(16) Në fazën e ardhshme të selektimit marrin pjesë kandidatët të cilët kanë numër të njëjtë të pikëve me kandidatët e ranguar të fundit të paragrafit (13) të këtij neni."

Neni 11

Në titullin para nenit 41 fjalët: "dhe teste" shlyhen.

Neni 12

Në nenin 41 në paragrafin (1) pas fjalës "nëpunës" presja zëvendësohet me lidhëzën "dhe", ndërsa fjalët: "dhe testi i personalitetit" shlyhen.

Në paragrafin (2) pas fjalës "provimit" presja dhe fjalët: "respektivisht të testit" shlyhen.

Në paragrafin (3) pas fjalëve: "dhënia e provimit" presja dhe fjalët: "respektivisht të testit" shlyhen, dhe pas fjalëve: "ka dhënë provimin" presja zëvendësohet me pikë, ndërsa fjalët: "respektivisht testin." shlyhen.

Në paragrafin (4) pas fjalëve: "30 minuta provimi" presja dhe fjalët: "respektivisht testi" shlyhen.

Në paragrafët (13), (14) dhe (15) fjalët: "dhe testet" shlyhen.

Paragrafët (16), (17), (18) dhe (19) shlyhen.

Neni 13

Neni 42 ndryshon si vijon:

(1) Kontrollimin e autenticitetit të provave e kryen Komisioni për selektim për çka kandidatët janë të obliguar t'i sjellin në këqyrje në origjinal ose kopje të verifikuar, të gjitha dëshmitë e theksuara në nenin 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, së paku tre orë para fillimit të intervistës.

(2) Për kandidatët të cilët nuk do t'i dorëzojnë dëshmitë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, procedura e selektimit përfundon.

(3) Kandidatët të cilët me sukses e kanë kaluar kontrollin e autenticitetit të provave kanë të drejtë të vazhdojnë në intervistë.

(4) Intervista zbatohet me gojë dhe/ose me shkrim.

(5) Në intervistë, nëpërmjet të pyetjeve të situatës, kontrollohen kompetencat e përgjithshme të nevojshme të punës për kategorinë të cilës i takon vendi i punës, dhe nëpërmjet të pyetjeve profesionale ose detyrave praktike, kontrollohen kompetencat e veçanta të punës nga përshkrimi i vendit të punës.

(6) Gjatë zbatimit të intervistës, Komisioni për selektim duhet të përcaktojë edhe nëse kandidati e plotëson kushtin nga neni 31 paragrafi (1) alineja 2 të këtij ligji, dhe kryen ndarjen e pikëve në mënyrë përkatëse.

(7) Në afat prej tri ditësh nga dita e zbatimit të intervistës, në pajtim me pikët e fituara nga selektimi administrativ, provimi për nëpunës administrativ dhe intervista, për kandidatët të cilët kanë fituar së paku 60% të numrit të përgjithshëm të pikëve në të gjitha fazat paraprake të procedurës së selektimit, Komisioni përgatit rang-listë përfundimtare të kandidatëve të cilët me sukses i kanë kaluar fazat e procedurës për selektim dhe të njëjtën e publikon në ueb faqen e Agjencisë."

Neni 14

Titulli i nenit 43 dhe neni 43 shlyhen.

Neni 15

Në nenin 48 paragrafi (4) pas fjalëve: "ueb faqja e institucionit" presja fshihet dhe shtohen fjalët: "dhe të Agjencisë".

Në paragrafin (5) alineja 2 ndryshon si vijon:

"- të jetë në vend pune në nivel të drejtpërdrejtë më të ulët ose të jetë në vend pune në suaza të kategorisë së njëjtë në të cilën është vendi i punës për të cilin është publikuar konkursi intern."

Neni 16

Neni 50 ndryshon si vijon:

(1) Sekretari, respektivisht personi udhëheqës në institucionin në të cilin nuk emërohet sekretar, formon Komision për selektim për avancim.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet nga:

- udhëheqësi i njësisë organizative në të cilën plotësohet vendi i punës përmes procedurës për avancim, i cili është kryetar i Komisionit dhe zëvendësi i vet nga radhët e nëpunësve udhëheqës administrativ të institucionit,

- udhëheqësi i njësisë organizative për menaxhim me resurset njerëzore ose nëpunësi administrativ i cili i kryen punët të cilat kanë të bëjnë me menaxhim me resurset njerëzore nëse nuk ka njësi organizative në institucionin i cili punëson, i cili është edhe zëvendës i tij nga radhët e nëpunësve administrativë udhëheqës nga institucioni dhe

- nëpunësi administrativ nga Sektori për selektim të kandidatëve për punësim në Agjenci, i cili është anëtar dhe zëvendës i tij.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni në institucionin në të cilin njësia organizative në të cilën plotësohet vendi i punës nëpërmjet procedurës për avancim nuk ka udhëheqës, kryetari i komisionit është nëpunës udhëheqës administrativ i emëruar nga sekretari, respektivisht personi udhëheqës i institucionit në të cilin nuk emërohet sekretar.

(4) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni në institucionin në të cilin njësia organizative për menaxhim me resurset njerëzore nuk ka udhëheqës ose nëpunës administrativ i cili i kryen punët të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin me resurset njerëzore, edhe anëtari i dytë i Komisionit është nëpunës administrativ nga Sektori për selektimin e kandidatëve për punësim në Agjenci.

(5) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, Komisioni për avancimin e nëpunësit administrativ udhëheqës përbëhet nga nëpunësi administrativ udhëheqës i institucionit, udhëheqësi i njësive organizative për menaxhim me resurset njerëzore ose nëpunësi administrativ i cili i kryen punët të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin me resurset njerëzore nëse nuk ka njësi organizative në institucionin i cili punëson edhe nëpunësi administrativ udhëheqës nga Sektori për selektimin e kandidatëve për punësim në Agjenci dhe zëvendësit e tyre.

(6) Anëtarët e Komisionit të cilët janë nga radhët e nëpunësve administrativë nga Sektori për selektimin e kandidatëve për punësim në Agjenci nuk mund të jenë nga radhët e anëtarëve të Komisionit për vendimmarrje për ankesat dhe kundërshtimet e nëpunësve administrativë në shkallë të dytë.

Neni 17

Titulli para nenit 68 dhe neni 68 shlyhen.

Neni 18

Në titullin para nenit 69 fjalët: "dhe mbikëqyrje të kontrollit ekstern" shlyhen.

Neni 19

Në nenin 69 paragrafi (2) shlyhet.

Në paragrafin (3), i cili bëhet paragraf (2), fjalët: "paragrafët (1) dhe (2)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (1)".

Neni 20

Në nenin 73 paragrafi (1) pika 24) shlyhet.

Pika 25) bëhet pikë 24).

Pika 26) shlyhet.

Pikat 27), 28), 29) dhe 30) bëhen pika 25), 26), 27) dhe 28).

Neni 21

Në nenin 74 paragrafi (4) presja pas fjalës "parregullsi" zëvendësohet me lidhëzën "dhe", ndërsa fjalët: "dhe zvogëlimi i rrogës për shkak të efektit të dobët" shlyhen.

Neni 22

Në nenin 77 në paragrafin (2) fjalët: "pikat 23) dhe 24)" zëvendësohen me fjalët: "pika 23)".

Paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (3).

Paragrafi (5) shlyhet.

Neni 23

Pas nenit 94 shtohet titull i ri dhe nen i ri 94-a, si vijon:

"Kompensimi për suksesin në punë

Neni 94-a

(1) Nëpunësit administrativ i cili është vlerësuar me notë vjetore "A", i ndahet kompensim për sukses në punë në lartësi të rrogës së pranuar në muajin e fundit të vitit për të cilin është kryer vlerësimi, nëse në buxhetin e institucionit janë siguruar mjete për atë dedikim.

(2) Për kompensimin nga paragrafi (1) i këtij neni vendos sekretari, respektivisht personi udhëheqës i institucionit në të cilin nuk emërohet sekretar, në bazë të propozimit të udhëheqësit të drejtpërdrejtë."

Neni 24

Në nenin 98 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Nëpunësit administrativ i ndërpritet marrëdhënia e punës nëse vlerësohet me notë "D" dy herë të njëpasnjëshme ose së paku tri herë gjatë pesë viteve të fundit."

Paragrafët (6), (7) dhe (8) bëhen paragrafë (7), (8) dhe (9).

Në paragrafin (9), i cili bëhet paragraf (10), fjalët: "paragrafi (6)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (7)".

Neni 25

Në nenin 101 paragrafi (1) në alinenë 1 fjalët: "dhe testet" shlyhen.

Në alinenë 5 fjalët: "dhe testet" shlyhen.

Alineja 6 shlyhet.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Gjobë në shumë prej 7.500 deri 15.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit udhëheqës të institucionit, nëse nuk emëron sekretar nga radhët e nëpunësve administrativë udhëheqës, në kundërshtim me nenin 23 paragrafët (6), (7) dhe (8) të këtij ligji në afat prej dy muajsh nga dita e emërimit të tij në funksion."

Në paragrafin (5) pas fjalës "provimi" presja dhe fjalët: "respektivisht testi" shlyhen.

Neni 26

Dispozitat nga nenet 4, 5, 6 dhe 7 të këtij ligji, me të cilat ndryshohen dispozitat nga nenet 24 paragrafi (2) pika g), 25 paragrafi (2) pika g), 26 paragrafi (2) pika g) dhe 36 paragrafi (1) alineja 4 dhe paragrafi (2) nga Ligji për nëpunës administrativë, dhe të cilat kanë të bëjnë me njohjen e njërës nga tri gjuhët e përdorura më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze, gjermane), do të fillojnë të zbatohen gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Nëpunësit administrativë të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në fillimin e zbatimit të dispozitave nga paragrafi (1) të këtij ligji, janë të obliguar ta japin pjesën e provimit për nëpunës administrativ me të cilën kontrollohet njohja e njërës nga tri gjuhët e përdorura më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze, gjermane) në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kandidatët për nëpunës administrativë dhe nëpunësit administrativë nga paragrafi (2) i këtij neni të cilët kanë marrë certifikatë të njohur ndërkombëtarisht ose dëshmi të përdorur ndërkombëtarisht të marrë deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk do të japin pjesë të provimit profesional për kontrollin e njohjes së njërës nga tri gjuhët e përdorura më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, franceze, gjermane) deri në skadimin e vlefshmërisë së dëshmisë së marrë.

Nëpunësve administrativë të cilët nuk do ta japin pjesën e provimit për nëpunës administrativ në afatin e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, do t'u ndërpritet marrëdhënia e punës.

Neni 27

Procedurat e filluara për punësim dhe avancim të nëpunësve administrativë deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16).

Neni 28

Institucionet nga neni 3 i Ligjit për nëpunës administrativ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16), aktet për sistematizimin e vendeve të punës do t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Për sigurimin e resurseve të nevojshme njerëzore për realizimin e procesit të zbatimit të Marrëveshjes kornizë, nëpunësit administrativë që kanë themeluar marrëdhënie pune në Sekretariatit për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë për kryerjen e punëve administrative, sipas nevojave të institucioneve nga neni 3 i këtij ligji, mund të sistemohen në to si nëpunës administrativë, përkatësisht lloj tjetër nëpunësish të përcaktuar me ligj të veçantë ose nëpunës publikë.

Neni 29

Pas përfundimit të vlerësimit të nëpunësve administrativ për vitin 2016 dhe 2017 nuk do të miratohet aktvendim për realizimin e masave për kontribut të shkëlqyeshëm dhe të dobët në pajtim me nenin 68 paragrafi (6) të Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16).

Pas përfundimit të vlerësimit të nëpunësve administrativë për vitin 2016 dhe 2017 nuk do të miratohet aktvendim për kompensim për sukses në punë në pajtim me nenin 23 të këtij ligji me të cilin shtohet nen i ri 94-a dhe aktvendim për ndërprerjen e punësimit në pajtim me nenin 24 të këtij ligji, me të cilin në nenin 98 shtohet paragraf i ri (6).

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".